

# RELACION PËRSHKRIMOR

## OBJEKTI RIKONSTRUKSION I RRUGËS “KAREMANAJ”, RRERËS

### 1. Gjendja aktuale

Rruga “Karemanaj” ndodhet në fshatin Rrerës të Njësisë Administrative Ruzhdie, qyteti Patos.




Rruga ka një gjatësi prej rreth 286 m dhe gjendja aktuale e kësaj rruge nuk është në kushte të mira për arsye se në këtë segment nuk janë bërë ndërhyrje prej kohësh, duke u bërë shkak për amortizimin e vazhdueshëm deri në gjendjen në të cilën ndodhet sot. Situata aktuale nuk lejon që

shkëmbimi midis 2 automjeteve të jetë i lirshëm për arsye të mungesës së gjërësisë së nevojshme. Gjithashtu mungesa e ndriçimit, mungesa e trotuareve si edhe mungesa e një sistemi kullimi të qëndrueshem përbën nje problem dhe shpesh bëhet shkak për amoritizimin e vazhdueshëm të ketij segmenti. Në këto kushte ky segment është mjaft problematik për banorët dhe automjetet që qarkullojnë dhe konsiderohet e domosdoshme ndërhyrja në rikonstruksionin, sistemimin dhe përmisimin e qarkullimit në zonë. Gjithashtu ndërhyrjet ne rrjetin e kanalizmive do të jenë dhe një lehtësim për qarkullimin e këmbësorëve në zonë e cila deri tani ka qenë e veshtirë për tu menaxhuar sidomos gjatë periudhës së reshjeve.

## 2. Përshkrim i Projektit

Projekti parashikon ndërhyrjen në të gjithë këtë segment me nje gjatësi totale rreth 286 m. Elementët përbërës kryesor të ketij segmenti janë karrexhata, e cila ka nje gjërësi asfalti prej 5 m ose 500 cm, kanale betonarme me permasa 50x50cm ne te dy krahet e rruges dhe bordura betoni (kunderbordura) 6x20 cm.

Punimet e shtresave do te jene perkatesisht: 3 cm shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 5 cm shtrese binderi me granil gur kave, shtrese stabilizant me trashesi 10 cm dhe shtrese çakelli mbeturine kave  $t=20\text{cm}$ , përhapur e ngjeshur makineri.



Rruga do të pajiset me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza, ku është parashikuar shtrim i tubave të brinjezuar me diametër përkatësisht 250 mm, ngritje e pusëve ekzistuese të KUZ dhe plotësim me shtresat përkatëse.

*Punoi: Silvana Mici*